

KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTE

Në Tiranë, sot me datë 13.11.2023, palët nënshkruese si më poshtë bien dakort për të lidhur këtë kontratë për shitblerje kuotash të kapitalit të shoqërisë LUKOVA BAYSIDE HOTEL&SPA, sh.p.k.

Shitësi:

Z. Hekuran BRAHIMAJ, i biri i Rystem, lindur në Katundisht, Përmet, më 13.08.1972 dhe banues në Rr. "Kodra e Bukur 15", Vorë, shtetas shqiptar, identifikuar me kartën e identitetit nr.031162491, me Nr. Personal H20813103N, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, (këtu e në vijim: Shitësi).

Blerësi:

Z. Turjan HYSKO, shtetas shqiptar, i lindur në Berat, më 30.03.1985 dhe banues në adresën: Margarita Tutulani; Nd. 10; H.1; Ap.11; Njësia Administrative nr. 5, Njësia Bashkiake nr. 5; 1019 Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. BI221545 me nr. Personal I50330003D, (këtu e në vijim: Blerësi).

Neni 1


- 1.1 Shitësi është ortak i vetëm i shoqërisë LUKOVA BAYSIDE HOTEL&SPA sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS M11906023S. Shitësi zotëron 1 kuotë në vlerën 100% të kapitalit të nënshkruar. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 300.000 Lekë.
- 1) Shitësi në bazë të vendimit datë 13.11.2023 të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë LUKOVA BAYSIDE HOTEL&SPA, sh.p.k., i shet Blerësit 1 (një kuotë) që përfaqëson 35% të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë, i cili pranon t'i blejë ato, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

Neni 2

- 2.1 Çmimi i shitjes së kuotes që përfaqëson 35% të kapitalit të shoqërisë LUKOVA BAYSIDE HOTEL&SPA, sh.p.k. është 105.000 Lekë.
- 2.2 Çmimi prej 105.000 Lekësh konsiderohet i likujduar në cash plotësisht me nënshkrimin e kontratës nga të dyja palët.

Neni 3

- 3.1 Me shitjen e kësaj kuote, sipas kësaj kontrate, shitësi humbet pronësinë mbi 35% të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë dhe blerësi bëhet pronar i 1 (një kuote) që përfaqëson 35% të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.



Neni 4

4.1 Shitësi deklaron se është pronar me të drejta të plota mbi përqindjen e kuotës që i transferon blerësit e cila është e lirë nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë, nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e saj apo t'u ketë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji deri në datën e sotme që të mund të jetë shkak për cënimin e kontratës apo titullin e pronësisë së blerësit mbi to.

Neni 5


- 5.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.
- 5.2 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 5.3 Dokumentet bashkëlidhur kësaj kontrate si pjesë integrale e saj do të jetë Vendimi i datës 13.11.2023 i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë LUKOVA BAYSIDE HOTEL&SPA, sh.p.k.

Kjo kontratë hartohet në 2 kopje me të njëjtën vlerë ligjore dhe palët pasi e lexuan dhe e gjetën në përputhje me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë e nënshkruajnë atë.

PALËT KONTRAKTORE

Shitësi

Hekuran BRAHIMAJ



Blerësi

Turjan HYSKO

Turjan Hysko

